



www.legjislatiioni.gov.al

# Buletini i Njoftimeve Zyrtare I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2016 – Numri: 31

---

Tiranë – E martë, 1 nëntor 2016

---

## PËRMBAJTJA

|                                                       | Faqe                                                                                                          |
|-------------------------------------------------------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| Njoftim i Kryeministrisë<br>nr. 6335, datë 31.10.2016 | Për aplikim për zgjedhjen e gjyqtarit të Shqipërisë në Gjykatën<br>Evropiane të të Drejtave të Njeriut..... 3 |



**NJOFTIM PËR APLIKIM**  
**Nr. 6335, datë 31.10.2016**

**PËR ZGJEDHJEN E GJYQTARIT TË**  
**SHQIPËRISË NË GJYKATËN**  
**EVROPIANE TË TË DREJTAVE TË**  
**NJERIUT**

Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës, voton brenda muajit prill 2017, kandidaturën për gjyqtarin e ri të Shqipërisë në Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ). Këshilli i Evropës fton qeverinë shqiptare të paraqesë brenda datës 20 mars 2017, listën me propozime për tre kandidaturat më të përshtatshme për këtë pozicion.

Ky njoftim për aplikim bazohet në Udhërrëfyesin e Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës CM (2012) 40-add, datë 29.3.2012. Mandati i gjyqtarit është për një afat prej 9 (nëntë) vjetësh dhe mbaron pas përfundimit të këtij afati ose kur ai/ajo arrin moshën 70 vjeç. Kandidatët nëse zgjidhen, duhet të jenë në gjendje të mbajnë këtë detyrë për të paktën sa gjysmën e mandatit 9-vjeçar, para se të arrijnë moshën 70 vjeç.

**Aplikanti duhet të plotësojë këto kritere:**

- Të jetë shtetas shqiptar;
- Të ketë arsim të lartë juridik;
- Të ketë të paktën 15 vjet përvojë pune si gjyqtar, prokuror, avokat, profesor ose lektor i së drejtës, nëpunës i nivelit të lartë në administratën publike, me një veprimtari të spikatur në fushën e së drejtës, kryesisht në fushën e të drejtave të njeriut. Përparësi do të kenë kandidatët me përvojë praktike në sistemin e drejtësisë;
- Të mos ketë mbajtur funksione politike në administratën publike ose pozicione drejtuese në një parti politike gjatë 10 vjetëve të fundit përpara kandidimit;
- Të ketë karakter të lartë moral në përputhje me pikën 1, të nenit 21, të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut;
- Të zotërojë një nga gjuhët zyrtare të Këshillit të Evropës (anglisht ose frëngjisht) si dhe së paku të ketë njohuri bazë të gjuhës tjetër. Do të konsiderohet përparësi zotërimi i të dyja gjuhëve zyrtare të Këshillit të Evropës.

**Dokumentet që duhet të dorëzohen janë:**

- Kërkesë për aplikim;

- Kopje e kartës së identitetit;
- CV në gjuhën shqipe dhe CV të formatizuar sipas modelit në linkun e mëposhtëm, në një nga gjuhët zyrtare të Këshillit të Evropës (anglisht ose frëngjisht);  
[http://assembly.coe.int/CommitteeDocs/2009/ModelCVE\\_N.doc](http://assembly.coe.int/CommitteeDocs/2009/ModelCVE_N.doc)

- Dokumente të diplomimit dhe kualifikimeve shkencore;

- Dokument që të provojë vjetërsinë në profesion;

- Dokumente që provojnë njohjen dhe zotërimin e gjuhëve zyrtare të Këshillit të Evropës apo gjuhëve të tjera të huaja;

- Vetëdeklarim që është person i padënuar/dënuar apo ndaj të cilit nuk janë dhënë masa sigurie apo dënim me vendim jopërfundimtar për kryerjen e krimeve, në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, i ndryshuar;

- Vetëdeklarim se interesat private nuk përmbajnë burime të paligjshme financiare, fshehje të pasurive, deklarime të rreme apo konflikt interesi, në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, dhe ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar;

*(Deklarimi i rremë përveç përgjegjësisë penale sipas ligjit, sjell përjashtimin nga çdo procedurë e mëtejshme).*

- Dokumente të tjera në funksion të përmbushjes së kritereve të tjera plotësuese.

Pas vlerësimit të dosjeve të aplikimit, kandidatët mund t'i nënshtrohen intervistimit, ku një pjesë e pyetjeve do të jenë në një nga gjuhët zyrtare të Këshillit të Evropës (anglisht ose frëngjisht).

**Afati i dorëzimit të aplikimit: 30 nëntor 2016**

**Adresa: Kryeministria**  
**Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, nr. 1.1000**  
**Tiranë - Shqipëri**

**Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm**  
**tel: 04 22 77 401**

Buletini i Njoftimeve Zyrtare shpërndahet falas në çdo pikë të Postës Shqiptare.  
Përmbajtja e Buletinit Zyrtar mund të konsultohet falas dhe pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare.

Tiranë, 2016